

## ZHVILLIMI KRONOLOGJIK I IMPLEMENTIMIT TË PPP-së NË ANP

- Më 12 qershor 2008 **vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 14/24** për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërmësror për të analizuar dhe implementuar Partneritetin Publik Privat për operimin dhe zhvillimin e ANP-së.
- Në Nëntor të 2008 emërohet **Njësia për Implementimin e Projektit PPP** në ANP.
- Në shkurt të 2009 **kontraktohet këshilltari për transaksion** Konsorciumi Naco-Innova - White and Case nga Holanda/SHBA për të bërë studimin e fizibilitetit për PPP e mundshme në ANP.
- Më 09 qershor 2009 Konsorciumi Naco-Innova-White and Case prezantuan rekomandimet e tyre për PPP në ANP, të cilat rekomandime ishin të bazuara në analizën e Vlerës - për-para. Forma e PPP-së e rekomanduar ishte si ne vijim:
  - Struktura Kontraktuese: Dizajno – Ndërto – Financo- Opero – Transfero (DNFOT)
  - Kohëzgjatja e Kontratës: 20 Vite
  - Investimet e kërkuara : Opsioni 2 i Master Planit
  - Niveli Minimal i Kapaciteteve dhe Funkcionimit: IATA Standardi “C”
  - Fushëverprimi i Shërbimeve: Të gjitha shërbimet që ofrohen nga ANP, sh. a, duke përjashtuar Shërbimet e Navigimit
  - Pronësia e të gjitha aseteve mbetet me shtetin (si i vetmi aksionar i ANP sh.a)
- Më 12 qershor 2009 **vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/68** të vazhdohet me PPP në ANP me formën të DNFOT-së.
- Më 10 gusht 2009, **shpallet Kërkesa për Kualifikim** për PPP në ANP, me ç’rast fillon procedura dy-fazëshe e tenderimit për këtë projekt.
- Më 16 tetor 2009, **përfundon afati për Kualifikim**, me ç’rast pranohen 4 oferta.

- Më 12 nëntor 2009, **KDN aprovon rezultatin e vlerësimit te ofertave** për kualifikim, me ç'rast parakualifikohen konzorciumet në vijim
  - Fraport IC ICTAS Havalimani Isletme A.S
  - PAIC - Bouyges Batiment / Egis / Segap / Eurokoha Consortium
  - Limak – Aéroport de Lyon Consortium
  
- Me 17 dhjetor 2009 me **Vendimin e Qeverisë nr 02/99** KDN-PPP caktohet te përfaqësoj Republikën e Kosovës si Autoritet Kontraktues në prokurimin nr. PPP-09-001-611
  
- Më 30 dhjetor 2009 publikohet **Kërkesa për Propozim** dhe draft kontrata për konsorciumet e kualifikuara
  
- Më 25 janar 2010 **pranohen pyetjet dhe sqarimet e para** shtese rreth draft kontratës nga konsorciumet e kualifikuara
  
- Më 27 – 29 janar 2010 mbahet **Konferenca e Ofertuesve**
  
- Më 08 shkurt 2010 **publikohen sqarimet e para** rreth draft kontratës



Pristina International Airport  
Public - Private - Partnership